



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:030923
Datë: 05.03.2024
Numri i dokumentit: 05412931

PPP.nr.10/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Sami Gashi, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit, Xh.A., nga Fshati Zaplluzhë Komuna e Dragashit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat N.K., nga Prizreni, ndaj debitorit, N.F., nga Fshati Randobravë Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson avokat V.O., nga Prizreni, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.484/2023 të datës 22.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, jashtë seancës me datën 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET si i pa bazuar prapësimi i debitorit, N.F., nga Fshati Randobravë Komuna e Prizrenit, i ushtruar kundër Urdhrit për përmbartim, P.nr.484/2023 të datës 22.12.2023 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha me seli në Prizren, dhe i njëjti Urdhër për përmbartim, LIHET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Enis Hoxha nga Prizreni, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit Xh.A., nga Fshati Zaplluzhë Komuna e Dragashit, ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.484/2023 të datës 22.12.2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit përmbartimor, Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1897/2018, i dt.07.06.2021 i plotfuqishëm nga data 03.11.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 06.12.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, N.F., nga Fshati Randobravë Komuna e Prizrenit, që brenda afatit prej 7 ditësh pas pranimit të urdhrit, t'ia paguaj kreditorit detyrimin në të holla në shumën prej 66,000.00 Euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 26.02.2015 e deri në pagesën definitive, si dhe në emër të shpenzimeve kontestimore shumën prej 1,389.60 Euro, në të kundërtën përmbartimi të realizohet me ndalimin e mjeteve dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme deri në përmbushjen e kërkesës së kreditorit.

Debitori në afatin ligjor ka paraqitur prapësim, duke e kundërshtuar urdhrin e përmbaruesit privat si urdhër jo ligjor, për shkak të arsyeve të parapara në nenin 71 të LPP-së, me propozim që gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit caktimit të seancës gjyqësore të merr aktvendim me të cilën të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, ashtu që urdhri i përmbaruesit të lihet jashtë fuqie dhe të refuzohet propozimi i kreditorit si i pabazuar dhe jo ligjor.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar i autorizuari i kreditorit, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit, pasi që të thënat në prapësim janë të pa bazuara, ka propozuar që të refuzohet prapësimi i paraqitur nga debitori, dhe të mbete në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pretendimeve të kreditorit të paraqitura në përgjigjen në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se, prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të mbetet në fuqi, dhe atë për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se, organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht aktgjykimi në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, në kuptim të nenit 22 paragrafit 1, pika 1.1 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues mbi bazën e të cilit mund të caktohet përmbarimi në këtë çështje përmbarimore, ndërsa sipas nenit 24 par.1 të LPP-së, thuhet se: *“Vendimi gjyqësor me të cilën është urdhëruar përmbushja e kredisë për ndonjë dhënie apo bërje është i përmbarueshëm po qe se ka marrë formën te prerë si dhe po qe se ka skaduar afati për përmbushje vullnetare”,* po ashtu gjykata gjeti se aktgjykimi në fjalë i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1 të LPP-së, e sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pra ky dokument përmbarimor i përmban të gjitha të dhënat për tu përmbaruar në procedurën e përmbarimit, me këtë vendim gjyqësor është urdhëruar përmbushja e detyrimit në të holla, nga ana e debitorit, e më gjerësisht me përshkrimin e bërë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se aktvendimi mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri përmbarimor i plotëson kushtet sipas nenit 36, paragrafi 1 të LPP-së, me të cilën dispozitë përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmërisë për përmbarueshmëri”,* kështu aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.1897/2018 i datës 07.06.2021 i plotfuqishëm nga data 03.11.2023, ndërsa i ekzekutueshëm nga data 06.12.2023, dhe i njëjti aktgjykim është në origjinal, dhe e përmban klauzolën e përmbarueshmërisë dhe të ekzekutueshmërisë, dhe se për këtë arsye, pala kreditore, ka bërë propozimin për përmbarim të dhunshëm të këtij vendimi gjyqësor, te përmbaruesi privat si organ i përmbarimit.

Gjykata, i ka shqyrtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim, mirëpo debitori nuk e ka bërë të besueshëm prapësimin me prova konkrete, si dhe nuk i ka përmbushur asnjërin nga kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 71 lidhur me nenin 69 par.4 të LPP-së, andaj gjykata vlerëson se nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore për anulimin e urdhri për lejimin e përmbarimi.

Gjykata rikujton se në këtë procedurë nuk mund të lëshohet në vlerësimin e rrethanave tjera, me përjashtim të vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së tij, dhe pretendimet e dhëna të debitorit në prapësim, nuk janë pengesë për kryerjen e përmbarimit.

Gjykata, nuk e pa të arsyeshme të caktoj seancë dëgjimore, pasi që ka vlerësuar se nuk është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 par. 3 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit gjykata vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga të thënat si me lartë, bazuar në nenin 3 dhe 73 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.10/2024

Datë 05.03.2024

Gjyqtari
Sami Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pa kënaqur ka të drejtë të paraqes ankesë brenda afatit prej 7 (shtatë) ditëve, pas ditës së pranimit të këtij aktvendimi, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.